11115 - PAGESA PER SINDIKATE	231.64
11500 - TATI.I NDALUR NE TE ARDH.PERS.	3,299.10
11600 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNETORI	3,527.11
11700 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNEDHENE	3,527.11

13320 - SHPENZIMET E TELEFONIS MOBILE	725.65
13440 - SHËR.E NDRYSH.INTEL.&KËSHILLDH	1,500.00
13460 - SHERB KONTRAKTUESE TJERA	500.00
13610 - FURNIZIME PËR ZYRË	3,840.35
13620 - FURN.USHQIM &PIJE(JO DREKA ZYR	500.00
14210 - REKLAMAT DHE KONKURSET	40.00
14310 - DREKA ZYRTARE	199.50
66365 - PLANIF.URBAN.INSPEKC-SUHAREKË	205,821.54
11110 - PAGAT NETO PËRMES LIS.PAGAVE	39,337.29
11115 - PAGESA PER SINDIKATE	20.73
11500 - TATI.I NDALUR NE TE ARDH.PERS.	2,100.87
11600 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNETORI	2,182.14
11700 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNEDHENE	2,182.14
13140 - SHP.E UDHË.ZYRT.JASHTË VENDIT	899.50
13142 - AKOMODIMI-UDH.ZYRT.JASHT VEND	500.00
13320 - SHPENZIMET E TELEFONIS MOBILE	471.67
13440 - SHËR.E NDRYSH.INTEL.&KËSHILLDH	2,100.00
13610 - FURNIZIME PËR ZYRË	2,721.07
13620 - FURN.USHQIM &PIJE(JO DREKA ZYR	500.00
14210 - REKLAMAT DHE KONKURSET	355.40
14310 - DREKA ZYRTARE	295.80
31110 - NDËRTESTAT E BANIMIT	47,319.07
31690 - PAISJE TJERA	38,091.45
32000 - INVESTIMET NE VIJIM	62,258.11
33100 - TRANS.KAP.-ENTITETET PUBLIKE	4,486.30
73021 - ADMINISTRATA-SUHAREKE	112,897.04
11110 - PAGAT NETO PËRMES LIS.PAGAVE	29,874.06
11115 - PAGESA PER SINDIKATE	90.22
11500 - TATI.I NDALUR NE TE ARDH.PERS.	1,688.92
11600 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNETORI	1,666.01
11700 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNEDHENE	1,666.01
13143 - SHPEN.TJERA-UDH.ZYR.JASHT VEND	300.00
13210 - RRYMA	1,500.00
13250 - SHPENZIMET TELEFONIKE	500.00
13320 - SHPENZIMET E TELEFONIS MOBILE	580.00

13430 - SHËRBIME TË NDRYSH.SHËNDETSORE	1,558.00
13460 - SHERB KONTRAKTUESE TJERA	9,994.00
13470 - SHERBIME TEKNIKE	99.20
13509 - PAISJE TJERA <1000	258.30
13610 - FURNIZIME PËR ZYRË	700.00
13620 - FURN.USHQIM &PIJE(JO DREKA ZYR	600.00
13640 - FURNIZIME PASTRIMI	199.93
13780 - KARBURANT PER VETURA	1,610.29
13950 - REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	30.00
13951 - SIGURIMI I AUTOMJETEVE	310.50
13952 - TAKSA KOMUNALE E REGJIS.AUTOMJ	150.00
14010 - MIREMB.RIPARIMI I AUTOMJET.	595.50
14230 - SHPENZ PER INFOR PUB	386.00
14310 - DREKA ZYRTARE	199.10
22200 - PAG.PËR PËRFITUESIT INDIVIDUAL	58,341.00
73750 - SHËR. E KU. PRI. SHË.SUHAREKË	1,509,084.91
11110 - PAGAT NETO PËRMES LIS.PAGAVE	833,092.41
11115 - PAGESA PER SINDIKATE	8,293.96
11125 - ANTARSIM-ODA E INFERMIERVE TE KOSOVËS	601.77
11500 - TATI.I NDALUR NE TE ARDH.PERS.	51,830.50
11600 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNETORI	47,028.33
11700 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNEDHENE	47,028.33
13140 - SHP.E UDHË.ZYRT.JASHTË VENDIT	6,982.20
13210 - RRYMA	32,590.87
13220 - UJI	1,980.78
13230 - MBETURINAT	4,390.45
13250 - SHPENZIMET TELEFONIKE	599.27
13320 - SHPENZIMET E TELEFONIS MOBILE	2,103.68
13410 - SHËRBIMET E ARSIMITTRAJNIMIT	1,998.00
13430 - SHËRBIME TË NDRYSH.SHËNDETSORE	3,982.00
13460 - SHERB KONTRAKTUESE TJERA	8,644.80
13470 - SHERBIME TEKNIKE	998.90
13509 - PAISJE TJERA <1000	9,998.58
13610 - FURNIZIME PËR ZYRË	7,282.45
13620 - FURN.USHQIM &PIJE(JO DREKA ZYR	1,152.06

13630 - FURNIZIME MJEKËSORE	49,959.05
13640 - FURNIZIME PASTRIMI	2,526.60
13720 - NAFTE PER NGROHJE QENDRORE	7,256.18
13760 - DRU	21,169.54
13770 - DERIVATE PER GJENERATOR	312.42
13780 - KARBURANT PER VETURA	15,998.98
13950 - REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	260.00
13951 - SIGURIMI I AUTOMJETEVE	2,523.01
13952 - TAKSA KOMUNALE E REGJIS.AUTOMJ	655.00
14010 - MIREMB.RIPARIMI I AUTOMJET.	10,979.00
14024 - MIRËMBAJTJA OBJEKT.SHENDETSORE	35,000.00
14040 - MIREMB.E TEKNOLOGJ.INFORMATIVE	3,421.98
14050 - MIREMB.E MOBILEVE DHE PAISJEVE	799.00
14210 - REKLAMAT DHE KONKURSET	468.51
14310 - DREKA ZYRTARE	500.00
31122 - OBJEKTET SHËNDETËSORE	42,265.30
31660 - PAISJE SPECIALE MJEKSORE	214,421.00
31703 - VETURA TË NDIHMËS SË SHPEJTË	29,990.00
75556 - SHERBIMEET SOCIALE-SUHAREKE	74,182.02
11110 - PAGAT NETO PËRMES LIS.PAGAVE	54,017.79
11115 - PAGESA PER SINDIKATE	222.92
11500 - TATI.I NDALUR NE TE ARDH.PERS.	2,782.72
11600 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNETORI	3,001.45
11700 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNEDHENE	3,001.45
13210 - RRYMA	1,219.01
13220 - UJI	350.00
13230 - MBETURINAT	113.96
13250 - SHPENZIMET TELEFONIKE	410.00
13320 - SHPENZIMET E TELEFONIS MOBILE	596.09
13460 - SHERB KONTRAKTUESE TJERA	199.68
13470 - SHERBIME TEKNIKE	128.00
13501 - MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	331.00
13509 - PAISJE TJERA <1000	250.00
13610 - FURNIZIME PËR ZYRË	1,141.55
13620 - FURN.USHQIM &PIJE(JO DREKA ZYR	119.57

13720 - NAFTE PER NGROHJE QENDRORE	3,038.98
13770 - DERIVATE PER GJENERATOR	43.73
13780 - KARBURANT PER VETURA	1,183.76
13950 - REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	60.00
13951 - SIGURIMI I AUTOMJETEVE	193.56
13952 - TAKSA KOMUNALE E REGJIS.AUTOMJ	95.00
14010 - MIREMB.RIPARIMI I AUTOMJET.	568.46
14020 - MIREMBAJTJA E NDERTESAVE	1,000.00
14040 - MIREMB.E TEKNOLOGJ.INFORMATIVE	63.34
14310 - DREKA ZYRTARE	50.00
85012 - SHËRBIMET KULTURORE-SUHAREKË	391,035.71
11110 - PAGAT NETO PËRMES LIS.PAGAVE	68,029.63
11115 - PAGESA PER SINDIKATE	224.59
11500 - TATI.I NDALUR NE TE ARDH.PERS.	3,472.88
11600 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNETORI	3,775.27
11700 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNEDHENE	3,775.27
13140 - SHP.E UDHË.ZYRT.JASHTË VENDIT	685.50
13141 - MEDITJA-UDHE.ZYRT.JASHT VENDIT	907.60
13142 - AKOMODIMI-UDH.ZYRT.JASHT VEND	175.30
13310 - SHPENZIMET PER INTERNET	1,045.00
13320 - SHPENZIMET E TELEFONIS MOBILE	1,000.00
13440 - SHËR.E NDRYSH.INTEL.&KËSHILLDH	999.85
13460 - SHERB KONTRAKTUESE TJERA	439.00
13509 - PAISJE TJERA <1000	1,078.60
13610 - FURNIZIME PËR ZYRË	1,834.00
13620 - FURN.USHQIM &PIJE(JO DREKA ZYR	1,999.95
13820 - AVANS PER UDHETIME ZYRTARE	800.00
14230 - SHPENZ PER INFOR PUB	496.00
14310 - DREKA ZYRTARE	1,499.80
31124 - OBJEKTET SPORTIVE	30,000.00
31129 - FUSHAT SPORTIVE	112,780.58
31690 - PAISJE TJERA	4,439.75
31935 - BLERJA E LIBRAVE	1,890.00
31123 - OBJEKTET KULTURORE	8,950.50
31270 - MIRMBAJTJA INVESTIVE	8,842.62

21110 - SUBV.PËR ENTITETET PUBLIKE	45,000.00
21120 - SUB.PËR ENT.PUBL.KULT(TEA.BIB)	25,999.00
21200 - SUB.PËR ENTIT.JOPUBLIKE	5,000.00
32000 - INVESTIMET NE VIJIM	55,895.02
92060 - ADMINISTRATA-SUHAREK	530,628.22
11110 - PAGAT NETO PËRMES LIS.PAGAVE	59,670.22
11115 - PAGESA PER SINDIKATE	181.16
11500 - TATI.I NDALUR NE TE ARDH.PERS.	3,487.63
11600 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNETORI	3,333.71
11700 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNEDHENE	3,333.71
13130 - SHPENZ.UDHË.ZYRT.BRENDA VENDIT	69,904.28
31121 - OBJEKTET ARSIMORE	84,527.84
13132 - AKOMODIMI-UDH.ZYRT.BREND.VENDI	5,790.00
13133 - SHPENZ.TJERA-UDH.ZYR.BREN.VEND	1,974.00
13141 - MEDITJA-UDHE.ZYRT.JASHT VENDIT	998.20
13142 - AKOMODIMI-UDH.ZYRT.JASHT VEND	3,838.00
13143 - SHPEN.TJERA-UDH.ZYR.JASHT VEND	24,000.00
13320 - SHPENZIMET E TELEFONIS MOBILE	600.00
13501 - MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	14,761.18
13503 - KOMPJUTERË ME PAK SE 1000 Euro	1,987.00
13509 - PAISJE TJERA <1000	10,000.00
13610 - FURNIZIME PËR ZYRË	4,990.30
13620 - FURN.USHQIM &PIJE(JO DREKA ZYR	1,976.95
13760 - DRU	20,000.00
14040 - MIREMB.E TEKNOLOGJ.INFORMATIVE	491.00
14050 - MIREMB.E MOBILEVE DHE PAISJEVE	2,495.30
14210 - REKLAMAT DHE KONKURSET	600.00
14310 - DREKA ZYRTARE	935.00
21200 - SUB.PËR ENTIT.JOPUBLIKE	78,961.00
13220 - UJI	999.87
13230 - MBETURINAT	832.68
13250 - SHPENZIMET TELEFONIKE	574.12
13460 - SHERB KONTRAKTUESE TJERA	6,011.88
14023 - MIRËMBAJTJA E SHKOLLAVE	998.26
14210 - REKLAMAT DHE KONKURSET	685.00

31121 - OBJEKTET ARSIMORE	
32000 - INVESTIMET NE VIJIM	121,689.93
92430 - ARSIMI PARAFI & QERDH-SUHAREK	56,580.53
11110 - PAGAT NETO PËRMES LIS.PAGAVE	37,527.56
11500 - TATI.I NDALUR NE TE ARDH.PERS.	1,773.32
11600 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNETORI	2,068.59
11700 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNEDHENE	2,068.59
13130 - SHPENZ.UDHË.ZYRT.BRENDA VENDIT	149.00
13220 - UJI	1,000.00
13230 - MBETURINAT	1,734.13
13320 - SHPENZIMET E TELEFONIS MOBILE	120.00
13501 - MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	980.00
13509 - PAISJE TJERA <1000	999.10
13610 - FURNIZIME PËR ZYRË	396.40
13620 - FURN.USHQIM & PIJE(JO DREKA ZYR	5,109.51
13640 - FURNIZIME PASTRIMI	695.06
13720 - NAFTE PER NGROHJE QENDRORE	1,000.00
14023 - MIRËMBAJTJA E SHKOLLAVE	659.27
13650 - FURNIZIM ME VESHMBATHJE	300.00
93330 - ARSIMI FILORË-SUHAREK	4,524,684.93
11110 - PAGAT NETO PËRMES LIS.PAGAVE	3,668,827.38
11115 - PAGESA PER SINDIKATE	16,269.51
11500 - TATI.I NDALUR NE TE ARDH.PERS.	192,716.53
11600 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNETORI	204,098.37
11700 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNEDHENE	204,098.37
13130 - SHPENZ.UDHË.ZYRT.BRENDA VENDIT	2,887.40
13210 - RRYMA	25,572.85
13220 - UJI	7,330.93
13230 - MBETURINAT	8,117.57
13250 - SHPENZIMET TELEFONIKE	145.03
13310 - SHPENZIMET PER INTERNET	2,120.38
13320 - SHPENZIMET E TELEFONIS MOBILE	4,140.00
13501 - MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	8,301.70
13509 - PAISJE TJERA <1000	15,919.11
13610 - FURNIZIME PËR ZYRË	17,615.47

13620 - FURN.USHQIM &PIJE(JO DREKA ZYR	3,790.08
13640 - FURNIZIME PASTRIMI	15,639.84
13760 - DRU	89,175.04
13770 - DERIVATE PER GJENERATOR	2,231.52
14023 - MIRËMBAJTJA E SHKOLLAVE	16,563.09
14040 - MIREMB.E TEKNOLOGJ.INFORMATIVE	7,668.83
14050 - MIREMB.E MOBILEVE DHE PAISJEVE	11,455.93
94530 - ARSIMI I MESEM-SUHAREKE	1,492,793.67
11110 - PAGAT NETO PËRMES LIS.PAGAVE	1,201,394.47
11115 - PAGESA PER SINDIKATE	4,652.74
11500 - TATI.I NDALUR NE TE ARDH.PERS.	70,251.78
11600 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNETORI	67,174.13
11700 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNEDHENE	67,174.13
13130 - SHPENZ.UDHË.ZYRT.BRENDA VENDIT	1,328.00
13210 - RRYMA	13,939.74
13220 - UJI	4,867.63
13230 - MBETURINAT	1,380.10
13320 - SHPENZIMET E TELEFONIS MOBILE	540.00
13501 - MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	2,773.50
13504 - HARDUER PËR TEK.INFOR. <1000	587.06
13509 - PAISJE TJERA <1000	6,098.50
13610 - FURNIZIME PËR ZYRË	5,480.24
13620 - FURN.USHQIM &PIJE(JO DREKA ZYR	1,141.49
13640 - FURNIZIME PASTRIMI	4,974.19
13760 - DRU	28,201.00
13770 - DERIVATE PER GJENERATOR	821.56
14023 - MIRËMBAJTJA E SHKOLLAVE	5,103.23
14040 - MIREMB.E TEKNOLOGJ.INFORMATIVE	1,583.00
14050 - MIREMB.E MOBILEVE DHE PAISJEVE	3,327.18



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 dhe nenin 9, paragrafi 1, pika 7, të udhëzimit administrativ, Nr-27/20112, të nxjerr nga MPB-ja dhe Nr-03/2012, të nxjerr nga MAPL-ja me datën 22.08.2012, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoj këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1.

Me këtë vendim miratohet plani i veprimit për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën mars-dhjetor për vitin 2018.

Neni 2.

Pjesë për bërse e këtij vendimi është plani i veprimit për këshillin komunal për siguri në bashkësi për periudhën mars-dhjetor 2018, i hartuar ka këshilli komunal për siguri në bashkësi dhe i miratuar nga Kuvendi i Komunës në Suharekë.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës njëherit Kryesues i këshillit komunal për siguri ne bashkësi dhe Koordinatori i këshillit komunal për siguri ne bashkësi.

Neni 4.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”), nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI

01-Nr-_____

Me datë_____



**PLANI I VEPRIMIT PËR KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
MARS-DHJETOR 2018**

Nr. Re.	Muaji	Çështjet që shqyrtohen	Përgatit	Shqyrton 1	Shqyrton 2	Informon	Vërejtje
1.	Mars	<ol style="list-style-type: none">Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e KomunësAnalizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Suharekës për vitin paraprakTrajtimi i qenve endacak	Shërbimi i Kuvendit-Zyra e Kryetarit Policia e Kosovës DBZHRP	Anëtarët e propozuar për KKSB-ës	KKSB-së	Kuvendin e Komunës	
2.	Maj	<ol style="list-style-type: none">Shqyrtimi i dukurive negative, me theks të veçanti “Qendra zejtare Nr-1 dhe Nr-2” në SuharekëIdentifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçantaParapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror.Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm	DSHPSE, Shërbimi i Kuvendit-Zyra e Kryetarit Policia e Kosovës dhe Drejtoria e Arsimit	Kryetari i Komunës Policia KKSB-së	KKSB-së	Kuvendin e Komunës	
3.	Korrik	<ol style="list-style-type: none">Mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizueseMasat për parandalimin e lëmshë-kërkuesitPlani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave.	DSHPSE, Shërbimi i Kuvendit-Zyra e Kryetarit Policia e Kosovës Anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës KKSB-së,	KKSB-së	Kuvendin e Komunës	

4.	Shtator	<ol style="list-style-type: none"> 1. Trajtimi i mbrojtjeve të pyjeve nga dëmtuesit ilegal 2. Vetëdijesim nga minat dhe mjeteve tjera të pa shpërthyer nga lufta 3. Gjendja e sigurisë në shkolla 4. Siguria në Trafik 	<p>DBZHRP Shërbimi i Kuvendit- Zyra e Kryetarit Policia e Kosovës FSK-ja Drejtoria e Arsimit</p>	<p>Kryetari i Komunës Policia KKSB-së</p>	<p>KKSB-së</p>	<p>Kuvendin e Komunës</p>	
5.	Nëntor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla 2. Siguria në trafik. 3. Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje 4. Vjedhjet në territorin e Komunës së Suharekës 	<p>Shërbimi i Kuvendit- Zyra e Kryetarit DKA Policia e Kosovës</p>	<p>Kryetari i Komunës KKSB-së DSHPSE, DUPH</p>	<p>KKSB-së</p>	<p>Kuvendin e Komunës</p>	
6.	Dhjetor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike. 2. Mungesa e parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik 3. Përgatitja e planit të veprim për vitin 2019. 	<p>Anëtarët e KKSB-së Shërbimi i Kuvendit- Zyra e Kryetarit Anëtarët e KKSB-së FSK-ja</p>	<p>Policia KKSB-së FSK-ja</p>	<p>KKSB-së</p>	<p>Kuvendin Komunës</p>	

Suharekë, 27.02.2018

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ



KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
 SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
 MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL 3/2018

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 3 (tretë) të rregullt për vitin 2018 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 23.02.2018
Ora : 13.00

Prezentë në takim:

<p>z. Nexhat Ramadani</p> <p>z. Bashkim Ndrecaj</p> <p>z. Ardian Shala</p> <p>z. Alban Berisha</p> <p>z. Shefket Kolgeci</p> <p>z. Xhemajl Kabashaj</p> <p>znj. Elmaze Kabashi</p> <p>znj. Bulëza Kuçi</p> <p>znj. Shqipe Ramaj</p> <p>z. Sali Bytyqi</p> <p>z. Reshat Selimaj</p> <p>z. Shefket Kuçi</p> <p>z. Bexhet Kuçi</p> <p>z. Aziz Bytyqi</p> <p>z. Gazmend Gashi</p> <p>znj. Besa Kuçi</p> <p>znj. Mirlinda Muqa</p> <p>znj. Vlora Neziri</p>	<p>z. Rilind Krasniqi</p> <p>z. Jeton Rakaqi</p> <p>z. Arbërim Basha</p> <p>z. Dardan Berisha</p> <p>znj. Marigona Gashi</p> <p>znj. Florie Bytyqi</p> <p>z. Sami Hajdari</p> <p>znj. Albana Bytyqi</p> <p>z. Osman Selimaj</p> <p>z. Leonard Shala</p> <p>z. Dugagjin Palushi</p> <p>znj. Laureta Tafaj</p> <p>z. Gëzim Kryeziu</p> <p>-----</p>	<p>Të pranishëm të tjerë</p> <p>Kryetari Komunës</p> <p>Medjat dhe qytetart</p> <p>OSCE, LMT, KDI</p> <p>Habibe Bytyqi</p> <p>Xheladin Sadikaj, etj</p>
--	---	---

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. Miratimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt vendimit për themelimin e këshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSB);
3. Shqyrtim i projekt vendimit për formimin e komisionit komunal i aksionerëve;
4. Shqyrtim i projekt vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave;
5. Shqyrtimi i projekt vendimit për miratimin e raportit për vitin 2017, të komisionit komunal të aksionerëve të NPL „Stacioni i autobusëve” SH.A. me seli në Suharekë;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake të realizuara në vitin 2016 dhe 2017, të përcillen për shfrytëzim në vitin 2018;
7. Pyetje - përgjigje

Kryesuesi - i përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi me këtë rend dite dhe propozon edhe një pik shtesë për përdhënien e pronës në shfrytëzim për ndërtimin e stadiumit në Studenqan.

Kryetari – i njofton asamblist me arsyet se pse është shtua kjo pikë.

Aprovohet rendi i ditës me pikën shtesë

Pika e parë - Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar

**Dardan Berisha
Ardian Shala
Rilind Krasniqi
Dugagjin Palushi
Japin vërejtje në procesverbal**

Aprovohet me vërejtje

Pika e dytë - Shqyrtimi i projekt vendimit për themelimin e këshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSB)

Kryesusi – lexon emrat e anëtarëve të këtij komiteti të cilët janë caktuar sipas udhëzimit.

Gëzim Kryaziu – Ju kam dhanë nga një material ku nga OJQ-të kam propozua atë të kryqit kuq të jetë anëtar në KKSB.

Ardian Shala – Kërkoj një sqarim si janë zgjedh përfaqësuesit e OJQ-ve, mediave dhe ato të minoriteteve.

Avni Bytyqi – i njofton me procedurën se si emërohen këta përfaqësues.

Reshat Selimaj – Në të kaluarën ky komitet nuk ka qen nivel dhe a paguhen anëtarët e këtij komiteti.

Avni Bytyqi – ju sqaron çështjen e pagesës e cila është e paraparë të paguhet.

Leonard Shala – edhe KPF kam kërkuar sqarime se a kanë diskutuar me OJQ-të dhe Mediat për këta përfaqësues tash na vjen edhe një propozim tjetër nga OJQ-së.

Aziz Bytyqi – e mbështes propozimin për përfaqësuesin e kryqit të kuq.

Jeton Rakaqi - KPF pyeta a mund të shtohen anëtarët në këtë komitet ju thatë jo e tash vjen një kërkesë me shkrim prej kryqit kuq për me shtua.

Avni Bytyqi – jep sqarime për kërkesën e kryqit kuq dhe për shtimin e anëtarëve në këtë komitet.

Dugagjin Palushi – mendoj se është e mundur shtimi i anëtarëve në këtë komitet, sipas rregullores duhet të caktoj një koordinator, ka ardhë edhe një kërkesë nga bashkësia fetare protestante.

**Me 28 vota për e
3 apstenime approvehet**

Pika e tretë - Shqyrtim i projekt vendimit për formimin e komisionit komunal i aksionerëve

Ardian Shala – kërkoj që të formohet komisioni si është formuar më herët dhe propozoj Alban Berishën.

Aziz Bytyqi – nga AAK propozojmë Reshat Selimaj.

Leonard Shala – duhet dy anëtar të jen të propozuara nga asambleja dhe të propozohen nga çdo parti nga një dhe të votohen.

Jeton Rakaqi – nga PDK propozojmë Rilind Krasniqin.

Nexhat Ramadani – KPF nuk kemi marrë vendim por kemi lan të sqarohet ne kuvend.

Sami Hajdaraj – mirë është të propozohet nga çdo parti pa marr parasysh a është parti e vogël apo e madhe por duhet të gjejmë kompromis e jo vetëm partitë e mëdha po të punohet sa më mirë, propozoj Albana Bytyqin.

Vetëvendosja propozon Dugagjin Palushin.
Propozohen 5 anëtar dhe ç' do njëri votohet

Alban Berisha – 12 vota
Reshat Selimaj – 15 vota
Rilind Krasniqi – 15 vota
Albana Bytyqi – 8 vota
Dugagjin Palushi – 12 vota

Komisioni formohet prej 2 kandidatëve më të votuar

Reshat Selimaj

Rilind Krasniqi

Albana Bytyqi e propozuar nga kryetari.

Pika e katërt - Shqyrtim i projekt vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave

Kryesuesi kërkon të japin propozimet nga secila parti nga një kandidat;

Nga LDK-ja propozohet - Shefket Kolgeci

Nga AAK propozohet - Mirlinda Muqa

Nga PDK-ja propozohet - Florije Bytyqi

Nga Nisma propozohet - Sami Hajdari

Nga VV-ja propozohet - Dugagjin Palushi

Aprovohet unanimitisht

Pika e pestë - Shqyrtimi i projekt vendimit për miratimin e raportit për vitin 2017, të komisionit komunal të akcionerëve të NPL „Stacioni i autobusëve” SH.A. me seli në Suharekë;

Kryesusi – elaboron këtë raport pasi që edhe vet ka qen anëtar i këtij komisioni të akcionerëve

Pika e gjashtë - Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake të realizuara në vitin 2016 dhe 2017, të përcillen për shfrytëzim në vitin 2018

Kryesusi – kryesuesi i njofton me projektin mbi bartjen e mjeteve 2016 dhe 2017 për shfrytëzim 2018.

Leonard Shala – nuk është shënua shuma e mjeteve të 2016 që do të bartet dhe se kjo bartje e 2016 nuk është në rregull dhe pyet kryetarin se sa projekte janë krye e sa përfundim e sipër.

Ardian Shala – Të jen më të specifikuara këto projekte dhe pse një projekt është me dy kode.

Kryetari – ju përgjigjet pyetjeve të parafolësve.

Nexhat Ramadani – ky është një projekt vendim ku çdo vit detyrimisht bëhet se këto janë mjete të grumbulluara 3 muajt e fundit që mbesin të pa shpenzuara dhe duhet të barten.

Aprovohet unanimitisht

Pika e shtatë – pika shtesë Shqyrtim i projekt vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim për ndërtimin e stadiumit në Studenqan.

Ardian Shala – Ardian Shala – jemi për këtë ndarje, por a jene përputhje me ligjin a keni pas debat me qytetar dhe a ka mjete për këtë projekt.

Kryetari – jep sqarime se është ligjore dhe se ka pas debat me qytetar 150.000€ ministria e Rinis, Kulturës dhe Sportit i ka nda për fazën e parë.

Rilind Krasniqi – falënderon kryetarin që e përkrahin projektin e PDK-së nga niveli qendror për ndërtimin e stadiumit në Studenqan, kërkon nga kryetari të kërkoj falje publike qytetarëve të Studenqanit të cilët i mashtroi në fushat për ndërtimin e stadiumit brenda fshatit ku është aktualisht, ministria e rinis, kulturës dhe sportit i ka nda 150.000€.

Kryetari – jep sqarime se pse stadiumi nuk po ndërtohet brenda në fshat.

Gazmend Gashi – ne kemi mbajt një takim me qytetar dhe sportist për ndërtimin e stadiumit dhe në emër të kryesisë të fshatit e falënderoj kryetarin për ndërtimin e stadiumit.

Jeton Rakaqi - PDK ja merret me projekte të mëdha e jo të vogla.

Leonard Shala – jemi pro për një vendim të tillë por ka ardhur shumë shpejt pa debatuar pasi që ka të bëj me ndarjen e pronë publike dhe kërkoj që stadiumi ti ketë parametrat që kjo ti plotësoj nevojat e qytetit.

Nexhat Ramadani – si procedurë është dashtë të ndiqen kjo ka ardhur me ngut dhe jemi pro.

Elmaze Bytyqi – kam një kërkesë kur të jepen në shfrytëzim pronat komunale të elaborohen në slajde këto prona sepse ne s’kemi informacione se ku janë për afërsisht këto prona, të mbetet si praktik për çdo projekt vendim që ipet pronat e komunës në shfrytëzim.

Aprovohet unanimisht

Pika e tetë - Pyetje - përgjigje

Ardian Shala – Pyet për pronën afër vivës ku është hap një biznes dhe ju pengon qytetarëve si qëndron puna, na intereson marrëveshja me karitasin dhe duam ta shohim.

Kryetari - jep përgjigje pyetjeve të parafolësit

Leonard Shala – kamë kërkuar një raport për stadiumin e qytetit dhe kërkoj edhe kontratën ta shohim se çka është paraparë me karitasin, pse nuk vazhdon traseja e rrugës te varrezat e dëshmorëve, shtëpia e kulturës pse nuk punohet.

Beqir Berisha – përgjigjet pyetjes së parafolësit.

Bashkim Ndrecaj – kërkoj të di për rrugën brigada 123 në Shirokë kur do të bëhet, kam një pyetje për drejtoreshën e urbanizmit për vendosjen e shtyllave në trotuare se po pengojnë pasi që trotuaret janë të ngushta.

Kryetari – jep sqarime për pyetjet e parafolësit.

Jeton Rakaqi – Ku ka shkua inventari i shtëpisë së kulturës

Kryetari – i përgjigjet pyetjes së parafolësit

Reshat Selimaj – kemi probleme me pronën në fshatin Grejkoc se i japin në shfrytëzim pa pelqimin tonë dhe kerkon që mos të jepet edhe nëse jepet të ju jepet qytetarëve tanë.

Xhemajli Kabashaj – i sqaron parafolësit për dhënien e pronave në shfrytëzim në fshat.

Arbërim Basha – për mërgimtarët a do të ketë zyre të posaçme për lehtësim nxjerre të dokumenteve.

Kryetari – i përgjigjet pyetjes.

Rilind Krasniqi – kërkon që fotografia e presidentit të vendoset në sallën e asamblesë, pse e keni refuzuar kontratën me usaidin për bujqësi.

Laureta Tafaj - kur ka mu bë ujësjellësi në Bukosh dhe Reqan dhe djeponit në Grejkoc kur kanë mu largu.

Kryetari – ju jap përgjigje parafolësve.

Dardan Berisha – Kur do të ketë një raport nga drejtorja e arsimit për gjendjen nëpër shkolla dhe ç'ka do të ndërmirni për përmirësimin, sa ishin transparent drejtorët e shkollave për ndarjen e orëve që shkojnë me shoqëri dhe parti e që shkon në dëm të nxënësve.

Kryetari – i përgjigjet pyetjeve të parafolësit.

Dugagjin Palushaj – i inicion disa çështje të ngritura nga qytetarët dhe unë, sigurimi i mjeteve për projektin e ujësjellësit dhe kanalizimit për fshatin Budakovë, a ka ndonjë përgjigje rreth projektit të dërguar në qeveri për rrugën e Kokollarve deri te lagjja Buqa, transport publik dhe ai i nxënësve në fshatin Dvoran dhe Popolan nuk ka, trotuari në rrugën „Hasan Sejda” Sallagrazhdë, furnizimin me ujë i shkollës së Vraniqit, rregullimi i fushës së futbollit Gjinoc, rregullimi i trotuareve Bllacë, Web faqe të komunës kërkojmë funksionimin e saj dhe pasimin e të gjitha aktiviteteve, ngjarjeve, Vendimeve, procesverbalin propozoj të incizohet dhe pastaj të transkriptohet që të jen sa më të plota. Tabelat të cilat na dërgohen me material të dërgohen ne Excel e jo në word, Shirokë të shtrohet zhavorr para furrës metro dhe pjesë tjera ku ka banor, Nishor kanalizimi i ujërave të zeza pjesa e mbetur në lagjen Smakaj ku gjendja është shumë e keqe, lagjja Boka Grejqec mos ekzistimi i infrastrukturës po e lëshojnë vendbanimin shumë qytetar të jen prioritet asfaltimi i rrugës, të përkrahen bujqit, blegtorët

Takimi përfundoi në ora 15,40

**Proces mbajtësi
Hilmije Sahitaj**



Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 17, paragrafi 1, shkronja (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 10, pika 1.5, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012”, nenit 20, pika 7 dhe 11, të Rregullores QRK, Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E TRAFOSTACIONEVE
DHE DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni për vendosjen e trafostacioneve TSSHH nga KEDS-si dhe dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, për këto fshatrat si më poshtë:

- 1.1 Në fshatin Mushtisht në parcelën kadastrale **P-72116029-00333-1**, me sipërfaqe e përgjithshme prej; **39886m²**, sipas certifikatës së pronës **nr.952-2/2018827**, datës 15.02.2018, zona kadastrale **Mushtisht**, vendi i quajtura “**Nerezine**”, evidentuara pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **9m²** për vendosjen e trafostaconit,
- 1.2 Në fshatin Dobërdelan në parcelën kadastrale **P-72116016-02525-0**, me sipërfaqe e përgjithshme prej; **7551m²**, sipas certifikatës së pronës **nr. 1186**, datës 02.02.2018, zona kadastrale **Dobërdelan**, vendi i quajtura “**Çuka**”, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **9m²** për vendosjen e trafostaconit.
- 1.3 Në fshatin Bukosh në parcelën kadastrale **P-72116005-01419-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **11654m²**, sipas certifikatave të pronës **nr. 1138-2018**, datës 02.03.2018, zona kadastrale **Bukosh I**, vendi i quajtura “**Fshat**”, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **9 m²** për vendosjen e trafostaconit,

Neni 2

Pronat e cekura në neni 1, të këtij vendimi jepen në shfrytëzim pa kompensim në afat për 99 (nëntë dhjetë e nëntë) vite.

Neni 3

3.1 **OBLIGOHET** shfrytëzuesi i cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që **pronën e paluajtshme** të cekur në nenin 1.1 deri 1.3, të këtij vendimi, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

3.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

3.3 Komuna e Suharekës e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës për realizimin e interesave publik të Komunës të ndryshoj lokacionin në një vend tjetër.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis e Komunës së Suharekës, të cilat do të bëjnë parcelizimin dhe skicimin në teren për vendosjen e trafostacionit dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), te Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 5, të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008” dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, e në mbështetje neneve 15, 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën,-----
--, miratoj këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni komunal i aksionarëve nga Komuna e Suharekës për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Ekoregjioni”, me këtë përbërje të re:

1. -----, i emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtar/e
2. -----, i emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtar/e
3. -----, i emëruar nga Kryetari Komunës-----anëtar/e

Neni 2

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë të përcaktuar me Ligjin, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008” dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, lidhur me Ligjin Nr-02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-39/2008” dhe ligjet tjera që janë në fuqi.

Neni 3

Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Ndërmarrjen Publike Lokale “Ekoregjioni” Sh.A, me seli në Suharekë.

Neni 4

4.1 Mandat i anëtareve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

4.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-8449, i datës 01.12.2014, për formimin e komisioni komunal i aksionarëve.

KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01-Nr-_____

Me datë _____

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI